



Datë: 16.07.2025
Numër Protokolli: 4854/2025

A.nr.783/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani- kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Bajraktari Gashi-anëtare, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.783/2025, të datës 30.04.2025, të parashtruar nga ankuesja, D.G-D, organit të punësimit/Komuna e Klinës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 16.07.2025 mori këtë;

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.783/2025, e datës 30.04.2025 e parashtruar nga ankuesja, D.G-D.

II. Anulohet Konkursi me numër reference RN00016714, Grupi i Buxhetit dhe Financave për pozitën e punës “*Zyrtar për zotimin e mjeteve buxhetore*” i shpallur me datë 13.02.2025 nga Komuna e Klinës, si dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë e rekrutimit.

III. Obligohet Kryetari i Komunës dhe Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës që të ndërmerr të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën **II** të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesja, D.G-D (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesja), me datë 30.04.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2881/2025 të regjistruar nën shenjë A.nr.783/2025, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference **RN00016714**, të shpallur sipas Konkursit publik të datës 13.02.2025, nga Komuna e Klinës Grupi i Buxhetit dhe Financave për pozitën e punës “*Zyrtar për Zotimin e Mjeteve Buxhetore*”, klasa e pozitës Profesional 2, numri i kërkuar 1.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 23.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Klinës, ndërsa kjo e fundit, më datë 28.05.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova:: Ankesën me nr prot 2881/2025 të datës 30.04.2025 e D.G e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftim për rezultatin përfundimtar të datës 07.04.2025; Kopjen e letërnjoftimit; Formularin e vlerësimit të përgjithshëm të esesë së kandidatit të datës 02.04.2025; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës me nr prot 783/2025 I datës 28.05.2025; Konkursi; Lista e aplikantëve; Lista e kandidatëve të aprovuar; Vendimin e datës 25.03.2025. Njoftimin e datës 17.03.2025; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 07.04.2025; Akt emërimit e B.H e datës 29.08.2024; Vendimin e datës 19.11.2024; Vendimin e datës 17.03.2025; Vendimin e datës 07.03.2025; Akt emërimit e A.D të datës 30.08.2024; Pyetjet e hapura për testin individual; Formularët e vlerësimit të përgjithshëm të esesë së kandidatëve nga Komisioni i Pranimit të datës 02.04.2025; Formularët e vlerësimit individual të anëtareve të Komisionit për kandidatin në intervistë të datës 07.04.2025 ; Aplikacionin e A.E të datës 26.02.2025; Aplikacionin e D.D të datës 04.03.2025; Aplikacionin e E.N të datës 11.03.2025; Aplikacionin e F.B të datës 21.02.2025; Aplikacionin e F.R të datës 14.02.2025; Aplikacionin e F.G të datës 23.02.2025; Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankueses, **është e bazuar**, sepse:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se, Komuna e Klinës më datë 13.02.2025 ka shpallur Konkursin me numër reference RN00016714, Grupi i Buxhetit dhe Financave për pozitën e punës “Zyrtar për Zotimin e Mjeteve Buxhetore”, klasa e pozitës Profesional 2, numri i kërkuar 1, ku afati për aplikim ka qenë nga data 14.02.2025 deri më 15.03.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë tetë (8) kandidatë, ndër ta edhe ankuesja, e cila ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke i plotësuar kushtet e konkursit, ndërsa, e njëjta i është nënshtruar edhe fazës së testimit me shkrim dhe ka mbledhur gjithsejtë katërdhjetëpikëdy (40.2) pikë, nuk ka marrë pikë të pamjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, sikurse parashihet me nenin 9 paragrafi 4 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim.* Njësia e Personelit në Komunën e Klinës , më datë 07.04.2025 ka publikuar Njoftimin nr.02-111-9687/25, nga i cili njoftim rezulton se kandidatja e suksesshme për procedurën përkatëse është shpallur A.E me 88.2 pikë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se pyetjet e testit me shkrim dhe eseja nuk janë parashtruar nga fusha e njohurive dhe tjetër pretendim ankimor i ankueses është se në listën e ngushtë janë përfshirë kandidatë që nuk e kanë përvojën e punës nga fusha për të cilën është zhvilluar procedura e rekrutimi.

Kolegji i Këshilli, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një*

*fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen Konkursit publik me numër reference RN00016714, Grupi i Buxhetit dhe Financave për pozitën e punës “Zyrtar për Zotimin e Mjeteve Buxhetore”, klasa e pozitës Profesional 2, në Komunën e Klinës, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë , Financa apo kontabilitet* **Përvoja e punës e kërkuar:** *Së paku 1 (një) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës, dhe si rrjedhojë Kolegji vlerësoj se kriteret e përgjithshme për pozitën përkatëse të punës kane qenë në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.**

Si rrjedhojë, bazuar në kuadrin përkatës ligjor, si dhe shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës Kolegji ka gjetur se pretendimi ankimor i ankueses se procedura përkatëse e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me ligjin material, është e bazuar sepse, ngase duke ju referuar shkresave të administruara të lëndës, konstatohet se Komuna e Klinës ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Po ashtu, Kolegji nga administrimi i provave të çështjes të parashtuar nga palët në procedurë ka gjetur se nuk qëndron pretendimi ankimor i ankueses se organi përkatës i punësimit në këtë procedurë të rekrutimit nuk ka marrë për bazë parimin e meritës, ngase, Kolegji ka analizuar dosjen e aplikimit të kandidatit fitues si kandidati me më shumë pikë znj.A.E, ku dhe vërtetohet se e njëjta lidhur me kriterin e arsimit ka ofruar si Dëshmi Diplomën e datës 26.10.2021 me nr.2676 të lëshuar nga Fakulteti i Biznesit në Universitetin drejtimi Financa dhe Kontabilitet “Haxhi Zeka” në Pejë, dhe mori titullin Bachelor i Arteve Kontabilitetit dhe Financa, duke plotësuar kështu kriterin arsimor, ndërsa sa i përket plotësimit të kriterit të përvojës së punës kandidatja në fjalë ka bashkangjitur Kontratën e punës për kohë të caktuar të lëshuar nga “Viva Fresh ” prej datës 01.01.2023 deri më datë 31.03.2023, nga rrjedhë se e njëjta nuk ka plotësuar kriterin e përvojës së punës, ngase përvoja e punës e kandidatës nuk përkon me përvojën e punës për të cilën është duke u zhvilluar procedura përkatëse e rekrutimit, at të Zyrtarit për buxhet dhe financa , siç edhe është kërkuar në konkursin e datës 13.02.2025 sepse kriteri për përvojën e punës është: **Përvoja e punës e kërkuar:** *Së paku 1 (një) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës ndërsa kandidatja fituese si dëshmi ka Pasqyrën e trustit për periudhën 16.03.2022—24.02.2025 që ka punuar në Viva Fresh23 muaj dhe tre muaj në Finca Kosovo, por e njëjta nuk posedon as kontratë as vërtetim, përveq pasqyrës së trustit , Kolegji i Këshilli, konstaton se kandidatja fituese me dëshmitë e ofruara me rastin aplikimit nuk ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale, gjegjësisht atë të kriterit të përvojës së punës prej një (1) viti në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Ndërsa ankuesja posedon Diplomën e datës 20.09.2021 me nr.12037 të lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina “, dhe mori titullin Bachelor i Kontabilitetit, duke plotësuar kriterin e arsimit, ndërsa sa i përket plotësimit të kriterit të përvojës së punës e njëjta si dëshmi posedon Letër reference se e njëjta është duke punuar në “Wolfsden Consulting L.L.C. N.U.I: 811243334511 ADD: Klinë” prej datës 01.08.2020 ku vijon edhe tani, po ashtu posedon edhe Pasqyrën e Trustit Pensional për periudhën 16.03.2018-09.01.2024.

Andaj, nisur nga rrethanat dhe konstatimet e dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës, si njësi përgjegjëse, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, në fazën e verifikimit paraprak, gjegjësisht me rastin e përgatitjes së listës së ngushtë të kandidatëve që plotësojnë kriteret e konkursit, nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike dhe si rrjedhojë gabimisht ka zbatuar ligjin material, ngase për pozitën e punës *Zyrtar për Komunikim me Publikun*, ka përfshirë

në listë të ngushtë kandidatë të cilët nuk i kanë plotësuar kriteret e konkursit, si rrjedhojë njëri prej tyre është shpallur edhe kandidat fitues, veprime këto në kundërshtim me dispozitat e Ligjit 08/L-197 për Zyratë Publik, përkatësisht nenin 39 paragrafi 7 dhe 8, ku përcaktohet se: 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve; 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësi përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi, ndërlidhur me nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të këtij Ligji.

Si rrjedhojë, dhe siç u tha me lart, se përfshirja në listë të ngushtë e kandidatëve që nuk kanë plotësuar kriteret formale të konkursit, rrjedhimisht shpallja e njërit prej tyre kandidat fitues e bëjnë të paligjshëm çdo veprim të ndërmarr në të gjitha fazat e rekrutimit, e kështu që në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit konstaton se për shkak të shkeljeve të evidentuara si më lartë kjo procedurë e rekrutimit konsiderohet e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, thënë si me sipër e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.783/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, D.G-D;
- Njesisë se Personelit në Komunën e Klinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.